



Deklaratë për shtyp

Kryeministri Laschet: Nordrhein-Westfalen po vendos sot sinjalin tjetër për fqinjësi të mirë dhe për më shumë Europë.

14.05.2020
Faqja 1 nga 2

Zyra për shtyp e
kancelarisë së shtetit
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Federata dhe republikat vendosin t'i japin fund detyrimit për t'u karantinuar për të kthyerit nga udhëtimet në shtetet e BE dhe të zonës Schengen dhe gjithashtu të Britanisë së Madhe – Kryeministri Laschet: Hapi është lehtësim i madh për njerëzit veçanërisht në rajonet kufitare / Rregullorja e re hyn në fuqi sot në mesnatë në Nordrhein-Westfalen

Qeveria e republikës ju komunikon:

Republikat kanë rënë sot dakord me federatën se në ditët në vazhdim do t'i lirojnë nga detyrimi fillimisht dyjavor i karantinës në shtëpi udhëtarët që hyjnë dhe kthehen nga shtetet në lidhje me BE dhe zonën Schengen (së bashku me shtetet e BE si Islanda, Norvegjia, Lihtenshtajni dhe Zvicra) si dhe Britaninë e madhe. Nordrhein-Westfalen do ta implementojë këtë marrëveshje duke filluar nga dita e sotme.

Kryeministri Armin Laschet shpjegon: „Gjermania do ta kapërcejë Koronavirusin vetëm kur lëvizja evropiane për njerëzit, mallrat dhe shërbimet të rikthehet plotësisht. Fundi i detyrimit të karantinës për qytetarët e shteteve të BE dhe Schengen, i cili u vendos sot nga federata dhe nga republikat, është një hap i rëndësishëm të cilin do ta implementojmë menjëherë sot. Si rrjedhim po i dërgojmë një mesazh të qartë vendeve tona fqinje në rrugën drejt rikthimit në normalitetin evropian.

Evropa ishte pjesë e zgjidhjes për ne që nga fillimi i pandemisë. Ne e kemi përforcuar këtë gjë dhe përkundrejt qeverisë federale. Në Nordrhein-Westfalen nuk janë mbyllur kufijtë në asnjë pikë me Belgjikën dhe Hollandën. Kemi ndenjur që në fillim në komunikim me fqinjët në një Task Forcë ndër-kufitare, në mënyrë që të luftojmë së bashku kundër

pandemisë së koronavirusit. Nuk bëhet fjalë vetëm për shkëmbim informacioni midis autoriteteve dhe regjimeve dhe ndihmës mjekësore të përbashkët, por edhe për të ndihmuar qeveritë të mëkëmben. Kjo përfshin gjithashtu në planin afatmesëm bërjen e mundur të turizmit ndërkufitar. Kjo mund të bëhet e mundur vetëm pa rregullin e karantinës.

Qeveria e Republikës është përgatitur dhe do të publikojë sot rregulloren e ndryshuar. Rregullat e reja vlejné duke filluar nga mesnata.“

Ndryshimet nuk do të lirojnë vetëm të rikthyerit nga shtetet e BE dhe Schengen si Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra si dhe gjithashtu Britania e madhe. Në të ardhmen do t'i kushtohet më shumë vëmendje në tërësi dhe dukurisë së përhapjes së infeksionit jashtë vendit. Prandaj, të rikthyerit nga vendet e tjera do të lihen gjithashtu të lirë nëse instituti Robert Koch përcakton se karantina është e panevojshme për këta vende. Nga ana tjetër, një ringjallje e pandemisë në shtetet e BE dhe të Schengen mund të çojë në rimarrjen e masave mbrojtëse në këta vende.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

[Informacion i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave](#)